



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**

**Prot.**

**Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020**

**Nr. Dok. 201900588/4**

**Lënda:** *Rekomandohet marrja e masave për garantimin e aksesit në drejtësi përmes sistemit të ndihmës juridike në zbatim të ligjit nr.111/2017.*

**MINISTRIT TË DREJTËSISË**  
Znj. Etilda GJONAJ (Saliu)  
Tiranë

*E nderuar Znj. Gjonaj,*

Avokati i Popullit në rolin e garantit të mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë, ka monitoruar me vëmendje vënien në zbatim të ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Ky ligj u miratua në datë 14.12.2017 dhe hyri në fuqi në datë 1 qershor 2018. Edhe më herët kemi trajtuar rëndësinë e këtij ligji dhe nevojën që shteti t'u garantojë këtë shërbim qytetarëve, duke marrë në konsideratë edhe numrin e kërkesave të ardhura për të kërkuar ndihmë juridike falas.<sup>1</sup>

Për këtë arsye, nga ana jonë është kryer hetim administrativ dhe janë ndjekur në vijim të gjithë hapat e ndërmarrë nga institucionet përgjegjëse si për miratimin e akteve nënligjore, ashtu edhe për ngritjen e strukturave të parashikuara nga ligji.

---

<sup>1</sup> Shumë qytetarë për shkak të emërtimit e përceptojnë institucionin e Avokatit të Popullit si një lloj agjencie që e ofron shërbimin avokator shtetëror falas dhe jo si një zyrë që mbikëqyr respektimin e të drejtave të njeriut nga organet e administratës publike. Ndaj në thelb kërkesat e paraqitura konsistojnë në nevojën për shërbim avokator në çështjet gjyqësore, ku ata janë palë.

Në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë viteve 2018 dhe 2019 ka ardhur një numër i lartë ankesash ku kërkohet ndihmë juridike falas. Këto ankesa vazhdojnë të vijnë në institucionin tonë kryesisht nga kategori me të ardhura të pakta apo të pamjaftueshme, individë të cilët e kanë të pamundur aksesin në gjykatë përmes avokatit privat. Çështjet për të cilat kërkohet ndihma ligjore falas kanë si objekt kryesisht çështje familjare (si divorce, kujdestari, detyrime pensioni ushqimor etj.), civile (si shkaktim dëmi, pjesëtim pasurie etj.), administrative, por nuk mungojnë edhe ato penale.

Vetëm gjatë vitit 2018, moment i cili përkon me hyrjen në fuqi të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në institucionin e Avokatit të Popullit, janë administruar 54 kërkesë/ankesa nga qytetarë të cilët kanë kërkuar asistencën tonë për të përfituar ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti.

Ky ligj sanksionon procedurat për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe të garantuar nga shteti, në formën e ndihmës juridike parësore (dhënia e informacioneve dhe këshillimit ligjor), ose të ndihmës juridike dytësore (dhënia e ndihmës juridike dhe ofrimi i mbrojtjes para gjykatës). Ligji nr.10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i ndryshuar, është shfuqizuar, si dhe është suprimuar Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike, në kohën që aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr.10039, datë 22.12.2008, të ndryshuar mbetën në fuqi deri në miratimin e akteve të reja nënligjore, për sa kohë nuk binin në kundërshtim me parashikimet e ligjit të ri.

Ligji nr.111/2017 parashikon krijimin e një personi juridik publik nën varësinë e Ministrisë të Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Aktet nënligjore dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në zbatim të ligjit të ri duhej të ishin miratuar dhe ngritur brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.<sup>2</sup> Pra, në muajin shtator 2018 ngritja e strukturës dhe miratimi i akteve nënligjore do të kishin vënë në zbatim ligjin.

Ndërkohë puna për ngritjen e kësaj drejtorie ka filluar vetëm pas miratimit të urdhrimit të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”, me më shumë se 6 muaj vonesë nga hyrja në fuqi e ligjit. Edhe në Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2019 për Shqipërinë vihet në dukje kjo vonesë e ngritjes së këtij institucioni.<sup>3</sup>

Avokati i Popullit është interesuar në mënyrë të përsëritur, duke theksuar rëndësinë e ngritjes së kësaj drejtorie tek institucionet përgjegjëse si: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Departamenti i Administratës Publike (DAP) dhe Kryeministria.

Lidhur me këtë çështje mes institucionit të Avokatit të Popullit, Ministrisë të Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe gjykatave ka pasur komunikime të vazhdueshme zyrtare, për të mundësuar orientimin e duhur të qytetarëve drejt

---

<sup>2</sup> Ligji nr nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 14.12.2017. Vlerësojmë se afati nga data e miratimit deri në datën e hyrjes në fuqi, 01.06.2018, ka qenë një afat i arsyeshëm dhe mëse i mjaftueshëm për të marrë të gjitha masat për të përmbushur detyrimin ligjor në nxjerrjen e akteve normative dhe ngritjen e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, si një nga institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike.

<sup>3</sup> Në raport, krahas vlerësimit të ndryshimeve pozitive në fushën e ndihmës juridike dhe legjislacionin penal në këtë drejtim, theksohet se pjesa më e madhe e rasteve që prekin grupet vulnerabël si personat me aftësi të kufizuara, romët, personat me probleme ekonomike etj, vazhdojnë të trajtohen nga shoqëria civile me mbështetjen financiare të donatorëve.

Shih: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

strukturave për caktimin e një avokati pa pagesë. Megjithatë, pavarësisht impenjimit institucional të ekspertëve të Avokatit të Popullit, për të sqaruar qytetarët mbi rrugën ligjore që ata duhet të ndjekin për të përfituar ndihmën juridike falas dhe të garantuar nga shteti, është vënë re se vazhdimisht ka pasur paqartësi mbi formën se si do të zbatohet ky ligj, si dhe procedurën që duhet të ndiqet nga qytetarët, të cilët shpesh janë përcjellë nga një derë institucioni në tjetrën, mes Ministrisë së Drejtësisë, gjykatave dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë.

Mosngritja në kohë dhe brenda afateve ligjore e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas nga Ministria e Drejtësisë, si dhe mosmiratimi i akteve nënligjore, bëri që për një kohë të gjatë të krijohesh një vakum për rregullimin e fushës për ofrimin e ndihmës juridike falas.

Në këtë mënyrë, mosrespektimi i detyrimeve ligjore nga organet përgjegjëse, me qëllim plotësimin e vakumit nënligjor dhe ngritjen brenda afateve ligjore të drejtorisë përkatëse, bën të pamundur aksesin në drejtësi të shtresave në nevojë dhe mungesën e përfaqësimit përmes një avokati falas në çështje të caktuara. Duhet theksuar se tejkalimi i afateve ligjore ka bërë të lindin shumë problematika në gëzimin e të drejtave themelore të grupeve me të ardhura të pamjaftueshme apo të pakta. Mundësia për të aksesuar në drejtësi e grupeve vulnerabël, parim i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe i pritshmërive të ligjshme, ka qenë për një kohë të gjatë inekzistente.

Në nenin 6 të ligjit nr.111/2017, përcaktohen institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike të cilat janë:

- a) Ministri i Drejtësisë;
- b) Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas;
- c) Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë;
- ç) gjykatat kompetente;

**Ministri i Drejtësisë**, zhvillon politikën shtetërore në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për të siguruar akses efektiv në sistemin e drejtësisë; i propozon Ministrisë së Financave projektbuxhetin vjetor për ndihmën juridike sipas legjislacionit në fuqi; i propozon Kryeministrit ngritjen e Drejtorisë për Ndhmën Juridike Falas në varësi të saj; miraton aktet nënligjore ku përfshihen formularët e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, formularët e kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore etj.

Nga detyrat e caktuara nga ligji, konstatohet se mbeten ende pa përfunduar nga Ministria e Drejtësisë:

- miratimi i krijimit të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pas marrjes më parë të mendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore, e organizuar si “njësi e drejtpërdrejtë e ofrimit të shërbimeve”, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Deri tani janë hapur vetëm dy qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore.<sup>4</sup> Mbetet domosdoshmëri ngritja

---

<sup>4</sup> Në datë 16.10.2019 është hapur në qytetin e Elbasanit qendra e shërbimit të ndihmës juridike parësore, ku janë rekrutuar dy punonjës me trajnim të posaçëm. Ndërsa në datën 27.02.2020 një qendër e tillë është hapur edhe në Fier mbështetur nga PNUD dhe qeveria austriake.

e këtyre qendrave në disa qytete të vendit, duke mbajtur parasysh zgjerimin sipas shpërndarjes gjeografike, për ofrimin e shërbimeve sa më afër komunitetit<sup>5</sup>.

- miratimi me udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, “Për kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifat përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore”;
- miratimi i projektudhëzimit të përbashkët me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë “Për rregullat e zbatimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore”.
- autorizimi i organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore dhe publikimi i listës në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë. Organizatat jofitimprurëse japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga Ministri i Drejtësisë. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Edhe pse janë miratuar aktet nënligjore lidhur me rregullat dhe procedurat e autorizimit, mbeten ende pa u autorizuar organizatat jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore.

**Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas** sipas parashikimeve ligjore zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike; përgatit raporte 3 mujore, vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me ndihmën juridike; menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike; mbledh dhe analizon informacionin, si dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim të saj; harton raportet vjetore; harton dhe lidh kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, miraton prognozet e trajnimit për punonjësit me trajnim të posaçëm; administron qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore; publikon listën e avokatëve të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore; publikon kontratën tip me avokatët dhe kryen pagesat e tyre etj.

Pas procedurave të realizuara për rekrutimin e stafit në përputhje me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, konstatohet se edhe pas një viti nga ngritja e kësaj drejtorie sipas urdhrat të Kryeministrit nr.59, datë 25.03.2019, organika nuk është plotësuar. Mungojnë drejtuesit e nivelit të lartë dhe të mesëm, të cilët kanë për detyrë administrimin, koordinimin dhe eventualisht identifikimin e nevojave për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike falas.

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas luan rol thelbësor për shërbimet e ndihmës juridike dytësore, pasi miraton me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë një projektudhëzim për kriteret dhe

---

<sup>5</sup> Në vendin tonë veprojnë disa qendra (OJF) të mbështetura financiarisht nga donatorë, të cilat ofrojnë ndihmë juridike falas përmes zbatimit në afate të projekteve, me objektiv rritjen e aksesit të individëve dhe grupeve në nevojë në sistemin e drejtësisë. Si të tilla mund të përmenden: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qendra "Res Publica", Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA), Albanian Disability Rights Foundation (ADRF), Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra "Streha" etj. Institucioni i Avokatit të Popullit është i vetëdijshëm dhe vlerëson punën e këtyre OJF-ve për të siguruar aksesin e shtresave në nevojë për ndihmë juridike falas dhe iniciativat e tyre për ngritjen e qendrave të ndihmës juridike me mbështetjen e donatorëve të ndryshëm, por ajo që synohet nëpërmjet këtij rekomandimi është vënia në funksion e mekanizmave ligjorë shtetërorë të parashikuar në ligjin nr.111/2017. Pra që individët e interesuar të përfitojnë nga ndihma juridike shtetërore dhe jo vetëm /kryesisht nga OJF-të e specializuara në këtë fushë.

procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, si dhe duhet të lidhë deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Aktualisht mbeten ende pa miratuar projektaktet që kanë të bëjnë me kriteret e caktimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore dhe të shpërblimit të tyre. Për këto dy akte duhet të realizohet dakordësia me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

**Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë** merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e avokatëve, që japin ndihmën juridike falas dhe specializimin e tyre në fushat përkatëse sipas kërkesave ligjore; merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët; merr masa disiplinore ndaj avokatëve, që ofrojnë ndihmë juridike falas, etj.

**Gjykata kompetente** shqyrton kërkesat për ndihmë juridike dytësore, si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, duke u shprehur me vendim të arsyetuar për pranimin ose jo të kërkesës, të cilin ia vë në dispozicion Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Nga korrespondenca që kemi pasur gjatë vitit 2019 me një numër të madh gjykatash të rretheve gjyqësore në shkallë vendi, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë shprehur se në këto gjykata nuk ofrohej ndihma juridike dytësore falas, si p.sh Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë etj.

Referuar klinikave ligjore të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore konstatohet se deri tani në universitetet publike janë ngritur dhe veprojnë 3 klinika ligjore, përkatësisht pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Universitetit “Aleksandër Mosiu”, Durrës; dhe Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Vlerësojmë se procesi i zgjerimit të këtij rrjeti, dhe forcimi i këtyre klinikave duhet të vijojë në të ardhmen. Kjo, pasi ato përbëjnë një potencial të konsiderueshëm në dhënien e këtij shërbimi bazuar në numrin e studentëve të regjistruar në programet që fakultetet e drejtësisë ofrojnë.

Nga ana jonë është vënë re se nga hyrja në fuqi e ligjit, ende mbetet shumë punë për ta bërë funksional dhe të zbatueshëm atë. Po ashtu, kategoritë me të ardhura të pamjaftueshme ose të pakta kanë nivel të ulët të njohurive mbi aksesin për ndihmën juridike dhe të drejtën për të kërkuar përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për sa i takon përparësive të ndihmës juridike, procedurës që duhet të ndjekin për ta përfituar atë dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë.

Duhet të ketë një informim dhe ndërgjegjësim të qytetarëve për ekzistencën dhe përmbajtjen e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, duke synuar krijimin e mundësive për të aksesuar format e ndryshme të ndihmës juridike falas dhe strukturat që e ofrojnë atë sipas ligjit.

Për këtë arsye, lind nevoja për grupet në nevojë të përgatiten fushata sensibilizuese ku të synohet edukimi ligjor, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në median e shkruar, shpërndarja e informacionit me një gjuhë të thjeshtë në rrjete sociale etj, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve vulnerabël.

Çmojmë se e drejta për akses në drejtësi është një e drejtë e cila duhet t'u garantohet nga shteti qytetarëve të tij, pasi është një e drejtë themelore në vlerën e një parimi kushtetues.

Aksesi në drejtësi është e drejtë e njohur nga paragrafi 10 i Deklaratës Universale të të Drejtëve të Njeriut ku shprehimisht parashikohet: ***“Gjithkush gëzon njëllëoj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale.”***Neni 14, paragrafi 1 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike<sup>6</sup>, neni 6, pika 1 e KEDNJ-së<sup>7</sup> dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë<sup>8</sup> konfirmojnë më tej këtë të drejtë.

E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe funksionimin e drejtësisë në vend. Me aksesin e lirë në gjykatë, kuptohet një e drejtë publike, e cila i jep titullarit të saj garancinë ligjore që të drejtohet për të kërkuar mbrojtjen e shtetit, duke detyruar organet gjyqësore kompetente të prononcohen mbi pretendimet e tij.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se të drejtat e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.<sup>9</sup>

---

<sup>6</sup> “Të gjithë janë të barabartë përpara gjykatave dhe organeve të drejtësisë.”

<sup>7</sup> Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.”

<sup>8</sup> “1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

<sup>9</sup> Vendimi nr.52, 14.11.2014 i Gjykatës Kushtetuese

Vendimet nr. 17, datë 18.07.2008; nr. 5, datë 06.03.2009; nr. 48, datë 24.09.2014 të Gjykatës Kushtetuese

Aksesi në drejtësi është konsideruar si element thelbësor i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa iu njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës. Kjo e drejtë është e lidhur ngushtë me nenin 6 të KEDNJ, duke nënkuptuar jo vetëm të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë mundësi.

Në procesin e rregullt ligjor, aksesit në drejtësi duhet kuptuar si elementi parësor për ekzistencën e elementeve të tjerë të tij, si e drejta për t'u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Nëse qytetarit nuk i garantohet e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, atëherë të drejtat e tjera nuk kanë kuptim dhe nuk mund të qëndrojnë pa të parën. Mohimi i të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor.

Shteti duhet të garantojë të drejtën për ndihmë juridike falas me qëllim që gjithsecili të ketë mundësinë pavarësisht statusit ekonomik, t'i drejtohet gjykatës për të shqyrtuar pretendimet e tij. Kjo sjell barazi midis personave në të drejtat që u njihen. Aksesi në drejtësi shihet si aftësi e njerëzve për të arritur zgjidhje përmes institucioneve të drejtësisë. Nuk ka akses në drejtësi nëse qytetarët i tremben shtetit, nuk i drejtohen atij, kur individët nuk kanë avokat apo kur ata nuk marrin informacionin dhe njohuritë e duhura mbi të drejtat.

Po ashtu në aktet e Këshillit të Evropës është vendosur standardi se ndihma juridike duhet të mundësohet për të gjithë qytetarët që nuk kanë mundësi ekonomike, jo vetëm për mbrojtjen ligjore në proceset gjyqësore, por edhe në rastet e nevojës për këshillim ligjor.<sup>10</sup>

Ndërsa, rezoluta 67/187 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 2012, përmban parime dhe udhëzime për ndihmën juridike në proceset penale.<sup>11</sup>

Pikërisht, me qëllimin e ofrimit të një shërbimi më cilësor, efikas dhe më pranë shtresave në nevojë u hartua edhe ligji i ri 111/2017, duke sjellë ndryshimet strukturore dhe procedurale përkatëse në përfitimin e ndihmës juridike falas. Ndaj, është i rëndësishëm krijimi i të gjitha garancive ligjore nga institucionet përgjegjëse, me qëllim gëzimin nga ana e tyre të të drejtave themelore në mënyrë të barabartë me qytetarët e tjerë.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet*

---

<sup>10</sup> Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës R(81)7 dhe R(93)1 synonin në thelb të tyre zgjerimin e ndihmës juridike falas në të gjitha fazat e proceseve civile, administrative, penale, përfshirjen e organizatave joqeveritare në ofrimin e këshillimit dhe ndihmës juridike, marrjen e masave për reduktimin e tarifave gjyqësore etj.

Shih Rekomandimin R (81)7: <https://rm.coe.int/168050e7e4>.

Shih Rekomandimin R (93)1: [https://search.coe.int/cm/Pages/result\\_details.aspx?ObjectId=09000016804df0ee](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016804df0ee)

<sup>11</sup> Nëpërmjet kësaj rezolute, shteteve u kërkohet të parashikojnë të drejtën për ndihmë juridike në kuadrin e brendshëm ligjor, të ofrojnë ndihmë juridike për viktimat e krimit dhe dëshmitarët, të ofrojnë ndihmë juridike për personat e ndaluar/dyshuar/arrestuar ose të dënuar për një vepër penale, të mundësojnë ndihmën juridike në mënyrë efektive dhe profesionale si dhe të parashikojnë mundësinë e mjeteve efektive të ankimit nëse ndihma juridike nuk jepet në kohë apo refuzohet.

*rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave për plotësimin e organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas me stafin e parashikuar në zbatim të urdhrin nr.59, datë 25.03.2019 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas”, duke konsideruar se drejtuesit e nivelit të lartë dhe të mesëm kanë rolin kryesor në administrimin, koordinimin dhe identifikimin e nevojave për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike falas.
- Marrjen e masave për miratimin e dy projektudhëzimeve me Dhomën Kombëtare të Avokatisë konkretisht: “Për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore”; “Për rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore”, në zbatim të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.111/2017.
- Marrjen e masave për miratimin me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të udhëzimit për shpërblimin e avokatëve.
- Marrjen e masave për ngritjen e qendrave të ndihmës juridike falas parësore, duke siguruar një shpërndarje të drejtë gjeografike.
- Marrjen e masave për realizimin e fushatave informuese lidhur me mënyrën e adresimit, kushtet që duhet të plotësojnë dhe procedurat që duhet të ndjekin për të aplikuar, duke u kushtuar më shumë vëmendje problematikave të grupeve në nevojë, me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve për ndihmën juridike falas.
- Marrjen e masave për autorizimin e organizatave jofitimprurëse dhe listimin e tyre sipas detyrimeve ligjore, me qëllim ofrimin e ndihmës juridike parësore.
- Marrjen e masave për shtimin e klinikave ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë në bazë të marrëveshjeve përkatëse në shkallë vendi.
- Marrjen e masave për një konsultim të gjerë në të ardhmen lidhur me prioritetet e ndihmës juridike falas dhe përmirësimet, ku të jenë pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Së fundmi, duke vlerësuar përpjekjet e deritanishme, shprehim interesin tonë për nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Drejtorisë së



Ndihmës Juridike Falas, me synim konsolidimin e përpjekjeve dypalëshe, për të siguruar efektivitetin e ndihmës juridike falas dhe aksesin në drejtësi të kategorive me të ardhura të pakta ose të pamjaftueshme.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**